

L I G J
Nr.8475, datë 14.4.1999

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS KONSULLORE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË KROACISË

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 e 121 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare” me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Konventa Konsullore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kroacisë, nënshkruar më 14.9.1996.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KONVENTË KONSULLORE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË KROACISË

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kroacisë,

Me dëshirën për të forcuar miqësinë dhe për të thelluar bashkëpunimin e frytshëm reciprok,

Të nisur nga dëshira për rregullimin dhe përparimin e marrëdhënieve konsullore ndërmjet dy shteteve në përputhje me parimet e lehtësimit sa më të madh të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të shtetasve të tyre;

Vendosën të lidhin Konventën Konsullore dhe u morën vesh si më poshtë:

KREU I PARË
PËRKUFIZIME

Neni 1

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, shprehjet e mëposhtme do të kuptohen siç përcaktohet më poshtë:

(1) “Përfaqësi Konsullore” tregon çdo konsullatë të përgjithshme, konsullatë, nën-konsullatë ose agjenci konsullore;

(2) “zonë konsullore” tregon territorin që i është caktuar një përfaqësie konsullore për kryerjen e funksioneve konsullore;

(3) “shef i përfaqësisë konsullore” tregon personin e ngarkuar me detyrën për të vepruar në këtë cilësi;

(4) “zyrtar konsullor” tregon çdo person, përfshirë edhe shefin e përfaqësisë konsullore,

të ngarkuar me detyrën për të ushtruar funksione konsullore.

(5) “nëpunës konsullor” tregon çdo person të punësuar në shërbimin administrativ ose teknik të një përfaqësie konsullore;

(6) “anëtarë të personelit të shërbimit” tregon çdo person të punësuar në shërbimin e brendshëm të përfaqësisë konsullore;

(7) “anëtarë të përfaqësisë konsullore” tregon zyrtarët konsullorë, nëpunësit konsullorë dhe anëtarët e personelit të shërbimit;

(8) “anëtarë të personelit konsullor” tregon zyrtarët konsullorë, përveç shefit të përfaqësisë konsullore, nëpunësit konsullorë dhe anëtarët e personelit të shërbimit;

(9) “anëtarë të personelit privat” tregon një person që është punësuar vetëm në shërbimin privat të një anëtari të përfaqësisë konsullore;

(10) “pjesëtari i familjes” tregon bashkëshortin/ten e një anëtarit të përfaqësisë konsullore dhe fëmijët e tij ose të saj, prindërit, me kushtin që ata të jetojnë në të njëjtën përbërje familjare dhe janë në varësi nga anëtari i përfaqësisë konsullore.

(11) “lokale konsullore” tregon ndërtesat ose pjesë të ndërtesave dhe të territorit ngjitur me to, të cilat, pavarësisht se pronë e kujt janë, përdoren vetëm për qëllimet e përfaqësisë konsullore;

(12) “arkivat konsullore” përfshijnë të gjitha shkresat, dokumentat, korrespondencën, librat, filmat, shiritat magnetike dhe regjistrat e përfaqësisë konsullore, së bashku me materialin e shifrës dhe kodeve, kartotekat dhe të gjithë orenditë që shërbejnë për ruajtjen apo mbrojtjen e tyre;

(13) “anije” tregon çdo anije civile e cila gëzon të drejtën të mbajë flamurin e shtetit dërgues dhe e regjistruar në atë shtet;

(14) “aeroplan” tregon çdo mjet fluturimi civil i cili ka të drejtë të mbajë shenjat e regjistrimit të shtetit dërgues dhe i regjistruar në atë shtet;

KREU I DYTË HAPJA E PËRFAQËSISË KONSULLORE DHE EMËRIMI I ANËTARËVE TË PËRFAQËSISË KONSULLORE

Neni 2

1.Përfaqësia konsullore mund të hapet në territorin e shtetit pritës vetëm me pëlqimin e këtij shteti.

2.Selia qendrore e përfaqësisë konsullore, rangu dhe zona konsullore do të caktohen nga shteti dërgues, dhe do t’i nënshtrohen miratimit të shtetit pritës.

3.Shteti dërgues mund të bëjë ndryshime të mëvonshme në selinë qendrore të përfaqësisë konsullore, rangun e saj apo zonën konsullore të saj, vetëm me pëlqimin e shtetit pritës.

4.Miratimi i shprehur paraprak i shtetit pritës duhet të kërkohet gjithashtu edhe për hapjen e një zyre që formon pjesë të një përfaqësie konsullore ekzistuese me vendndodhje jashtë selisë qendrore të saj.

Neni 3

1.Shteti dërgues e pajis shefin e përfaqësisë konsullore me një dokument, në formën e letrës patentë apo të ndonjë instrumenti tjetër të ngjashëm, që jepet për çdo emërim, i cili vërteton cilësinë e tij dhe tregon, si rregull i përgjithshëm, emrin e tij të plotë, rangun dhe klasën e tij, zonën konsullore dhe selinë qendrore të përfaqësisë konsullore.

2.Shteti dërgues do t’i transmetojë në rrugë diplomatike apo me rrugë të tjera të përshtatshme letrën patentë apo instrumentin e ngjashëm Qeverisë së shtetit në territorin e të cilit shefi i përfaqësisë konsullore duhet të kryejë funksionet e tij.

3.Në qoftë se shteti pritës pranon, shteti dërgues mundet që në vend të letrës patente apo të ndonjë instrumenti tjetër të ngjashëm me të, t'i dërgojë shtetit pritës një njoftim që përmban të dhënat e parashikuara nga paragrafi i 1 i këtij neni.

4.Shefi i përfaqësisë konsullore pranohet të kryejë funksionet e tij nëpërmjet një autorizimi nga shteti pritës, të quajtur ekzekuturë, pavarësisht nga forma e këtij autorizimi.

5.Shteti që refuzon të japë ekzekuturën nuk është i detyruar për t'i treguar shtetit dërgues arsyet e këtij refuzimi.

6.Në përputhje me dispozitat e paragrafit 7 të këtij Neni, dhe Nenit 4 të kësaj Konvente, shefi i një përfaqësie konsullore nuk mund të fillojë detyrat e tij para marrjes së ekzekuturës.

7.Në pritje të marrjes së ekzekuturës, shefit të përfaqësisë konsullore mund t'i lejohe kryerja e përkohshme e funksioneve të tij. Në këtë rast zbatohen dispozitat e kësaj Konvente.

8.Në momentin që shefit të përfaqësisë konsullore i lejohe, qoftë edhe përkohësisht, kryerja e funksioneve të tij, shteti pritës duhet të informojë menjëherë autoritetet kompetente të zonës konsullore. Ai duhet të sigurojë gjithashtu marrjen e masave të nevojshme për t'i krijuar mundësi shefit të përfaqësisë konsullore që të kryejë detyrat e tij zyrtare dhe të përfitojë lehtësitë e dispozitave të kësaj Konvente.

Neni 4

1.Në qoftë se shefi i përfaqësisë konsullore nuk është në gjendje të kryejë funksionet e tij apo vendi i shefit konsullor është bosh, personi që vepron si shef i përfaqësisë mund të veprojë përkohësisht si shef i përfaqësisë konsullore.

2.Emri i plotë i kryerësit të detyrës së shefit të përfaqësisë do të bëhet i ditur ose nga misioni diplomatik i shtetit dërgues, ose, në qoftëse ky shtet nuk ka një mision të tillë në shtetin pritës, nga shefi i përfaqësisë konsullore, ose, në qoftë se ai nuk mund ta bëjë një gjë të tillë, nga çdo autoritetet kompetent i shtetit dërgues, Ministrisë së Punëve të Jashtme të shtetit pritës ose autoritetit që përcakton kjo Ministri. Si rregull i përgjithshëm ky njoftim duhet të jetë paraprak. Shteti pritës mund të bëjë pranimin si kryerës të detyrës së shefit të përfaqësisë të një personi që nuk është as nëpunës diplomatik dhe as zyrtar konsullor i shtetit dërgues në shtetin pritës, me kusht që të merret pëlqimi i këtij të fundit.

3.Autoritetet kompetente të shtetit pritës do t'i sigurojnë ndihmë dhe mbrojtje kryerësit të detyrës së shefit të përfaqësisë. Për kohën që ky person drejton përfaqësinë, ndaj tij do të zbatohen dispozitate kësaj Konvente mbi të njëjtat baza si dhe ndaj shefit të përfaqësisë konsullore. Megjithatë, shteti pritës nuk do të jetë i detyruar që t'i japë kryerësit të detyrës së shefit të përfaqësisë ndonjë lehtësi, privilegj apo imunitet të cilën shefi i përfaqësisë konsullore e gëzon vetëm në varësi të kushteve që nuk plotësohen nga kryerësi i detyrës së shefit të përfaqësisë.

4.Në rastet kur në rrethanat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, një anëtar i personelit diplomatik të misionit diplomatik të shtetit dërgues në shtetin pritës, caktohet nga shteti dërgues si kryerës i detyrës së shefit të përfaqësisë, ai do të vazhdojë të gëzojë privilegjet dhe imunitetet diplomatike në qoftë se shteti pritës nuk ka kundërshtim për këtë.

Neni 5

1.Ministria e Punëve të Jashtme e Shtetit pritës duhet të njoftoht për:

a.Emërimin e anëtarëve të përfaqësisë konsullore, arritjen e tyre pas emërimit në përfaqësinë konsullore, largimin e tyre përfundimtar apo përfundimin e funksioneve të tyre dhe për çdo ndryshim tjetër që ndikon në statusin e tyre, që mund të ndodhë gjatë shërbimit të tyre në përfaqësinë konsullore;

b.arritjen dhe largimin përfundimtar të një personi që i përket familjes së një anëtarit të

përfaqësisë konsullore dhe kur është e përshtatshme, faktin që një person bëhet ose pushon së qeni anëtar i familjes;

c. arritjen dhe largimin përfundimtar të anëtarëve të personelit privat dhe, kur është e përshtatshme, përfundimin e shërbimit të tyre në këtë detyrë;

d. angazhimin dhe largimin e personave me banim në shtetin pritës, si anëtarë të përfaqësisë konsullore ose si anëtarë të personelit privat që gëzon privilegjet dhe imunitetet.

2. Kur është e mundur, duhet të bëhet gjithashtu njoftimi paraprak për arritjen dhe largimin përfundimtar të tyre.

Neni 6

1. Autoritetet kompetente të shtetit pritës do t'i japin, pa pagese, çdo zyrtari konsullor një dokument të përshtatshëm, që vërteton identitetin dhe funksionin e tij.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni do të zbatohen gjithashtu për nëpunësit konsullorë, anëtarët e personelit të shërbimit dhe anëtarët e personelit privat, me kusht që këta të mos jenë shtetas të shtetit pritës dhe as persona me qëndrim të përhershëm në atë shtet.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, kur është e përshtatshme do të zbatohen edhe për anëtarët e familjes.

Neni 7

1. Zyrtarët konsullorë duhet të kenë në parim shtetësinë e shtetit dërgues.

2. Zyrtarë konsullorë nuk mund të emërohen persona që kanë shtetësinë e shtetit pritës, përveçse me miratimin e shprehur të këtij shteti që mund të tërhiqen në çdo kohë.

3. Shteti pritës mund t'i rezervojë të njëjtat të drejta lidhur me shtetasit e një shteti të tretë që nuk janë gjithashtu shtetas të shtetit dërgues.

Neni 8

1. Shteti pritës mundet të njoftojë në çdo kohë shtetin dërgues që një zyrtar konsullor është person non grata apo që ndonjë anëtar tjetër i personelit konsullor nuk është i pranueshëm. Kur ndodh një gjë e tillë, shteti dërgues, në varësi nga rasti, ose duhet të kthejë personin në fjalë në atdhe, ose t'u japë fund funksioneve të tij në përfaqësinë konsullore.

2. Në qoftë se shteti dërgues refuzon ose nuk arrin brenda një kohe të arsyeshme kryerjen e detyrimeve të tij sipas paragrafit 1 të këtij neni, shteti pritës, në varësi nga rasti, mundet ose t'i tërheqë ekzekuturën personit përkatës ose të mos e konsiderojë më atë si anëtar të personelit konsullor.

3. Personi i emëruar si anëtar i një përfaqësie konsullore mund të deklarohet i papranueshëm para arritjes në territorin e shtetit pritës, ose, në qoftë se ndodhet në shtetin pritës, para marrjes së detyrave të tij në përfaqësinë konsullore. Në një rast të tillë shteti dërgues do të tërheqë emërimin e tij.

4. Në rastet e përmendura në paragrafet 1 dhe 3 të këtij neni, shteti pritës nuk është i detyruar t'i japë shtetit dërgues arsyet e vendimit të tij.

Neni 9

Shteti dërgues mundet që pas njoftimit të shteteve të interesuara, t'i besojë një përfaqësie konsullore të hapur në një shtet të veçantë, ushtrimin e funksioneve konsullore në një shtet tjetër, në qoftë se nuk ka një kundërshtim të shprehur nga ndonjë prej shteteve të interesuara.

Neni 10

Pas njoftimit të përshtatshëm të shtetit pritës, përfaqësia konsullore e shtetit dërgues, mundet të ushtrojë, në qoftë se shteti pritës nuk kundërshton, funksionet konsullore në këtë shtet në emër të një shteti të tretë.

Neni 11

Çdo palë kontraktuese mundet, në kuadrin e marrëdhënieve dypalëshe, të emërojë dhe të pranojë zyrtarë konsullorë nderi dhe të zbatojnë ndaj tyre dispozitat e KREUt III të Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore, dhe, nëse është e mundur dispozitat e kësaj Konvente. Zyrtarët konsullorë të nderit mund të jenë shtetas të shtetit dërgues, të shtetit pritës ose të një shteti të tretë.

Neni 12

Funksionet e një anëtari të përfaqësisë konsullore do të përfundojnë, ndër të tjera:

- a) pas njoftimit që shteti dërgues i bën atij pritës se funksionet e tij kanë përfunduar;
- b) me tërheqjen e ekzekuturës;
- c) me njoftimin që shteti pritës i bën atij dërgues se ai nuk e konsideron më atë person si anëtar të personelit konsullor.

KREU III LEHTËSIRAT, PRIVILEGJET DHE IMUNITETET

Neni 13

1. Shteti pritës do të akordojë të gjitha lehtësirat për kryerjen e funksioneve të përfaqësisë konsullore, dhe nëpërmjet masave të nevojshme, do t'u mundësojë anëtarëve të përfaqësisë konsullore kryerjen e veprimtarive zyrtare dhe gëzimin e të drejtave, të privilegjeve dhe të imuniteteve të parashikuara në këtë Konventë.

2. Shteti pritës do t'i trajtojë nëpunësit konsullorë me respektin e duhur dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar çdo sulm ndaj personit, lirisë apo dinjitetit të tyre.

Neni 14

1. Stema e shtetit dërgues së bashku me shkrimin përkatës, i cili tregon përfaqësinë konsullore në gjuhët e vendit dhe në gjuhën e shtetit dërgues, mund të vihen në ndërtesën e përfaqësisë konsullore dhe në rezidencën e shefit të kësaj përfaqëse.

2. Flamuri kombëtar i shtetit dërgues mund të vendoset në ndërtesën e përfaqësisë konsullore dhe në rezidencën e shefit të përfaqësisë konsullore.

3. Flamuri kombëtar i shtetit dërgues mund të vendoset, gjithashtu, në mjetet e transportit të shefit të përfaqësisë konsullore, kur këto mjete përdoren për punë zyrtare.

4. Në ushtrimin e të drejtës të parashikuar nga ky nen do të merren parasysh ligjet, aktet nënligjore dhe praktika e shtetit pritës.

Neni 15

1. Lokalet konsullore janë të paprekshme. Autoritetet e shtetit pritës nuk do të hyjnë në atë pjesë të lokaleve konsullore e cila përdoret ekskluzivisht për qëllimet e punës të përfaqësisë konsullore, përveçse me miratimin e shefit të përfaqësisë konsullore, ose të personit të caktuar

prej tij, ose, nga shefi i misionit diplomatik të shtetit dërgues. Në rast zjarri ose të ndonjë fatkeqësie të ndonjë natyre tjetër, e cila kërkon masa urgjente, miratimi i shefit të përfaqësisë konsullore apo i shefit të misionit diplomatik ose i personave të autorizuar me shkrim nga këto shefa mund të konsiderohet i dhënë.

2.Nën rezervën e paragrafit 1 të këtij neni, shteti pritës është veçanërisht i detyruar të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur lokalet konsullore nga ndonjë dëmtim apo zënie me forcë, si dhe të parandalojë prishjen e qetësisë ose prekjen e dinjitetit të përfaqësisë konsullore.

3.Lokalet konsullore, orenditë në to, prona e përfaqësisë konsullore dhe mjetet e saj të transportit nuk mund të jenë objekt i asnjë lloji forme rekuizicioni për qëllime të mbrojtjes kombëtare ose të përdorimit publik. Në rastin kur për këto qëllime është i nevojshëm shpronësimi, do të merren të gjitha masat e mundshme që të mos pengohet kryerja e funksioneve konsullore, dhe shtetit dërgues do t'i paguhet zhdëmtimi përkatës dhe efektiv.

Neni 16

1.Lokalet konsullore dhe rezidenca e shefit të përfaqësisë konsullore për të cilat shteti dërgues është pronar apo qeraxhi, ose personat që veprojnë në emër të tyre, janë të përjashtuar nga të gjitha pagesat, taksat dhe tatimet kombëtare, rajonale, lokale, të çfarëdo lloji me përjashtim të pagesave për shërbimet e veçanta të kryera.

2.Përjashtimi nga taksimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni nuk do të zbatohet për pagesat dhe taksat në rast se, sipas legjislacionit të shtetit pritës, ato paguhen nga personi i cili ka kontraktuar me shtetin pritës ose me çdo person që vepron në emër të tij.

Neni 17

Arshivat dhe dokumentet konsullore janë të paprekshme në çfarëdo kohe dhe kudo që mund të gjenden.

Neni 18

1.Në përputhje me ligjet dhe rregullat e shtetit pritës, shteti dërgues ka të drejtë:

a)të fitojë, posedojë ose të marrë me qera toke, ndërtesa ose pjesë ndërtese për vendosjen e përfaqësisë konsullore, rezidencës së shefit të përfaqësisë konsullore apo për banesat e anëtarëve të tjerë të përfaqësisë konsullore.

b)të ndërtojë apo adoptojë ndërtesa në tokën e marrë për qëllimet e mësipërme

c)të kalojë të drejtën e pronësisë për tokën që ka në zotërim, ndërtesat ose pjesët e tyre.

2.Në rast nevojë, shteti pritës do të ndihmojë përfaqësinë konsullore për marrjen e banesave për anëtarët e përfaqësisë konsullore.

3.Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk përjashtojnë shtetin dërgues nga detyrimi për të vepruar në përputhje me ligjet dhe kufizimet lidhur me ndërtimin, planifikimin urbanistik dhe mbrojtjen e trashëgimisë së qytetit, të zbatuara në zonën ku gjendet ose të gjenden toka në fjalë, ndërtesa apo pjesë të ndërtesës.

Neni 19

Në përputhje me ligjet dhe rregullat që kanë të bëjnë me zonën në të cilën, për arsye të sigurisë kombëtare, hyrja është e ndaluar, shteti pritës do të sigurojë në territorin e tij lëvizjen e lirë dhe udhëtimin për të gjithë anëtarët e përfaqësisë konsullore dhe anëtarët e familjes së tyre. Në asnjë rast shteti pritës nuk do të pengojë funksionarin konsullor gjatë kryerjes së funksioneve të tij.

Neni 20

1.Shteti pritës do të lejojë dhe mbrojë lirinë e komunikimit të përfaqësisë konsullore në të gjitha rastet e qëllimeve zyrtare. Përfaqësia konsullore mund të përdorë të gjitha mjetet e nevojshme, përfshirë korrieret diplomatikë dhe konsullorë, valixhet diplomatike ose konsullore si dhe korrespondencën e shifruar ose të koduar në komunikimin me qeverinë, misionet diplomatike dhe përfaqësitë e tjera konsullore të shtetit pritës kudo që të ndodhen ato. Megjithatë përfaqësia konsullore mund të instalojë dhe të përdorë radiotransmetues me miratimin e shtetit pritës.

2.Korrespondenca zyrtare e përfaqësisë konsullore është e paprekshme. Me emërtimin “korrespondencë zyrtare” kuptohet gjithë korrespondenca që ka lidhje me përfaqësinë konsullore dhe funksionet e saj.

3.Valixhja konsullore duhet të përmbajë shenja të dukshme që vërtetojnë qënien e saj dhe si e tillë duhet të ketë brenda vetëm korrespondencën zyrtare, dokumente ose materiale të destinuara ekskluzivisht për qëllime zyrtare.

4.Valixhja konsullore nuk mund të hapet as të mbahet. Megjithatë, në rast se autoritetet kompetente të shtetit pritës kanë arsye serioze për të besuar se valixhja përmban diçka tjetër të ndryshme nga korrespondenca, dokumente ose materiale të përmendura në paragrafin 3 të këtij neni, ato mund të kërkojnë që personi i autorizuar i shtetit dërgues t’a hapë valixhen në praninë e tyre. Në rast se kjo kërkesë refuzohet nga autoritetet e shtetit dërgues, valixhja kthehet në vendin nga ku është nisur.

5.Korrieri konsullor do të pajiset me një dokument zyrtar që tregon statusin e tij dhe numrin e pakove që përmban valixhja konsullore. Korrieri konsullor është shtetas i shtetit dërgues dhe nuk mund të jetë një shtetas i shtetit pritës dhe as rezident i përhershëm i tij me përjashtim të rastit kur për këtë është dhënë miratimi nga shteti pritës. Shteti pritës e mbron korrierin konsullor në kryerjen e funksioneve të tij. Ai është i paprekshëm dhe nuk mund të jetë subjekt i asnjë lloji forme të arrestit apo të burgimit.

6.Valixhja konsullore mund t’i besohet komandantit të anijes apo avionit, që është parashikuar të ulet në një port hyrje të autorizuar. Komandantit i jepet një dokument zyrtar në të cilin specifikohet numri i paketave të cilat përbëjnë valixhen konsullore, por ai nuk konsiderohet korrier konsullor. Në marrëveshje me autoritetet përkatëse lokale përfaqësia konsullore mund të dërgojë një nga anëtarët e saj për të marrë direkt dhe lirisht në posedim valixhen konsullore nga komandanti i anijes apo avionit.

Neni 21

1.Funksionari konsullor nuk mund të ndalohej, të paraburgoset ose të burgoset apo t’i nënshtrohet masave të tjera të pengimit të lirisë, përveç se në rastin e një krimi të rëndë të bazuar në vendimin e autoritetit juridik kompetent ose për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

2.Funksionarët konsullorë dhe nëpunësit konsullorë gjatë kryerjes së funksioneve të tyre konsullore gëzojnë imunitetin nga juridiksioni i autoriteteve gjyqësore dhe administrative të shtetit pritës.

3.Dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni nuk do të zbatohen në rastin e ndonjë veprimi civil:

a.i cili është si rrjedhim i ndonjë kontrate që ka lidhur funksionari konsullor ose nëpunësi konsullor në të cilën ata nuk kanë vepruar në mënyrë të shprehur ose të nënkuptuar si agjent të shtetit dërgues; ose

b.nga një palë e tretë për dëmin që rezulton si pasojë e ndonjë aksidenti në shtetin pritës shkaktuar nga një automjet, anije apo avion;

c.në lidhje me trashëgiminë në të cilën anëtar i përfaqësisë konsullore vepron me cilësinë e trashëgimtarit, legatorit, të besuarit ,ruajtësit të pasurisë trashëgimore si person privat.

4.Dispozitat e paragrafeve 1 dhe 3 të këtij neni do të zbatohen respektivisht për anëtarët e familjes.

5.Në qoftë se autoriteti kompetent i shtetit pritës ka qëllim të ndalojë, arrestojë, burgosë një anëtar të stafit konsullor duhet pa vonesë të informojë për këtë gjë shefin e përfaqësisë konsullore. Në qoftë se fillohet proces penal kundër funksionarit konsullor, ai është i detyruar të paraqitet para autoriteteve kompetente. Megjithatë, procesi do të zhvillohet me respektin e duhur ndaj tij për shkak të pozitës zyrtare dhe me përjashtim të rastit të parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, në mënyrë që të cenohet sa më pak ushtrimi i funksioneve konsullore. Në rrethanat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, kur lind e nevojshme ndalimi i një funksionari konsullor, procesi kundër tij do të fillojë brenda një kohe sa më të shkurtër.

6.Në rast të arrestit ose ndalimit të një anëtar i personelit konsullor, ose të fillimit të procesit penal kundër tij, shteti pritës do të njoftojë menjëherë shefin e përfaqësisë konsullore. Në qoftë se shefi i përfaqësisë konsullore do t'i nënshtrohet një mase të tillë, shteti pritës do të njoftojë shtetin dërgues nëpërmjet rrugëve diplomatike.

7.Në qoftë se shefi i përfaqësisë konsullore, ose shefi i misionit diplomatik nuk është lajmëruar që më përpara mbi marrjen e masave sipas këtij neni, autoriteti kompetent i shtetit pritës do të informojë plotësisht përfaqësinë konsullore ose misionin diplomatik të shtetit dërgues mbi veprimin e kryer.

Neni 22

1. Anëtarët e përfaqësisë konsullore mund të thirren si dëshmitarë gjatë një procesi gjyqësor ose administrativ. Një nëpunës konsullor ose një anëtar i personelit të shërbimit, me përjashtim të rasteve të përmendura në paragrafin 3 të këtij neni, nuk do të refuzojë të dëshmojë. Në qoftë se një funksionar konsullor refuzon të dëshmojë, ndaj tij nuk mund të merren masa shtrënguese ose ndonjë formë tjetër sanksioni.

2.Autoriteti që kërkon dëshminë e një funksionari konsullor duhet të shmangë ndërhyrjen në kryerjen e funksioneve të tij. Në rast se është e mundur autoriteti mund të marrë një dëshmi të tillë në rezidencën e tij ose në përfaqësinë konsullore, ose të pranojë deklaratën e tij me shkrim.

3.Anëtarët e përfaqësisë konsullore nuk janë të detyruar të dëshmojnë mbi faktet, të cilat lidhen me kryerjen e funksioneve të tyre apo të japin korrespondencën zyrtare ose dokumente të tjera që lidhen me të.

Gjithashtu ata gëzojnë të drejtën të refuzojnë dëshminë si dëshmitarë ekspertë lidhur me ligjet e shtetit dërgues.

Neni 23

1.Shteti dërgues mund të heqë dorë nga privilegjet dhe imunitetet e parashikuara në nenet 21 dhe 22 të kësaj Konvente. Heqja dorë në çdo rast duhet të jetë në mënyrë të shprehur dhe do t'i njoftohet shtetit pritës me shkrim.

2.Fillimi i procedurave nga ana e funksionarit konsullor apo nëpunësit konsullor në rastin kur ai mund të gëzojë imunitet nga juridiksioni, i heq atij të drejtën që të gëzojë imunitetin sipas nenit 21 paragrafeve 2 dhe 3 të kësaj Konvente, kur është fjalë për ndonjë kundërpadi që ka lidhje direkt me padinë kryesore.

3.Heqja dorë nga imuniteti nga juridiksioni në funksion të procedurave civile ose administrative nuk do të konsiderohet sikur përfshin heqjen dorë nga imuniteti ndaj masave të ekzekutimit që rrjedhin nga një vendim gjyqësor, në lidhje me masa të tilla është e nevojshme një heqje dorë e veçantë.

Neni 24

1.Funksionarët konsullorë dhe nëpunësit konsullorë, si dhe anëtarët e familjeve të tyre përjashtohen në shtetin pritës nga çfarëdo lloj shërbimesh personale, shërbime publike të çfarëdo lloj natyre, dhe detyrime ushtarake siç janë ato që kanë të bëjnë me rekuizicionin, kontributetet ushtarake.

2. Megjithatë, dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk do të zbatohen ndaj ndonjë nëpunësi konsullor që nuk është nëpunës i përhershëm i shtetit dërgues ose që kryen ndonjë veprimtari private fitimprurëse në shtetin pritës ose ndaj ndonjë anëtari të familjes të një nëpunësi të tillë.

Neni 25

1.Anëtari i përfaqësisë konsullore dhe anëtarët e familjes së tij përjashtohen nga të gjithë detyrimet që rrjedhin nga ligjet dhe rregullat e shtetit pritës, përsa i përket regjistrimit të të huajve dhe lejeve të qëndrimit ose formaliteteve të tjera që kanë të bëjnë me të huajt.

2.Megjithatë, dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk do të zbatohen ndaj ndonjë nëpunësi konsullor që nuk është nëpunës i përhershëm i shtetit dërgues ose që kryen ndonjë veprimtari private me karakter fitimprurës në shtetin pritës ose ndaj ndonjë anëtari të familjes të një nëpunësi të tillë.

Neni 26

1.Anëtarët e përfaqësisë konsullore janë të përjashtuar, në lidhje me shërbimet që kryhen për shtetin dërgues, nga çdo detyrim në lidhje me lejet e punësimit, punësimin të parashikuara nga ligjet dhe rregullat e shtetit pritës që kanë të bëjnë me punësimin e të huajve.

2.Anëtarët e stafit privat të funksionarëve konsullorë apo të nëpunësve konsullorë, në qoftë se nuk kryejnë ndonjë veprimtari fitimprurëse në shtetin pritës do të përjashtohen nga detyrimet e paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 27

1.Funksionarët konsullorë, nëpunësit konsullorë, si dhe anëtarët e familjeve të tyre do të përjashtohen nga të gjitha pagesat dhe taksat, personale ose reale, kombëtare, rajonale dhe lokale, përveçse:

(a) taksat indirekte të cilat për natyrën e mallit apo të shërbimit përfshihen në çmimin e tij;

(b) pagesat ose taksat mbi pasurinë e paluajtshme private të vendosura në territorin e shtetit pritës, me rezervën e dispozitave të nenit 16 të kësaj Konvente;

(c) detyrime të pasurisë së luajtshme, trashëgimisë dhe detyrime për kalimin e të drejtës së pronësisë të vendosura nga shteti pritës;

(d) detyrime dhe taksa mbi të ardhurat private përfshirë fitimet nga kapitali i cili rrjedh nga shteti pritës, dhe taksa mbi kapitalin e investuar në ndërmarrjen tregtare apo financiare në shtetin pritës;

(e) regjistrimi, pagesa për gjykatën ose regjistrimin gjyqësor, tatimet hipotekare dhe pullat, me rezervën e nenit 16 të kësaj Konvente.

2.Anëtarët e përfaqësisë konsullore që punësojnë persona, paga e të cilëve nuk është e përjashtuar nga taksat mbi të ardhurat në shtetin pritës, janë të detyruar t'u përmbahen detyrimeve të vendosura nga ligjet dhe rregullat e vendit pritës mbi të punësuarit në lidhje me pagesën e taksës mbi të ardhurat.

3.Anëtarët e personelit të shërbimit janë të përjashtuar nga taksat dhe tatimet mbi pagat

që marrin nga kryerja e shërbimeve të tyre.

Neni 28

1.Në përputhje me ligjet dhe rregullat e tij që mund të miratojë, shteti pritës do të lejojë importimin, eksportimin dhe përjashtimin nga të gjitha taksat doganore përveç detyrimeve dhe pagesave për ngarkim, transport dhe depozitim, shkarkim, si dhe shërbimeve të ngjashme, për:

(a) materiale për përdorim zyrtar të përfaqësisë konsullore;

(b) artikuj përfshirë mjetet e transportit të destinuara për përdorim vetjak nga ana e nëpunësit konsullor ose anëtarëve të familjes së tij, përfshirë edhe materialet që kanë të bëjnë me banimin e tij. Materialet e konsumit nuk mund të kalojnë një sasi të nevojshme për plotësimin e kërkesave të tyre.

2.Nëpunësit konsullorë gëzojnë privilegje dhe përjashtime të parashikuara në paragrafin e 1 të këtij neni lidhur me materialet e sjella në fillim të funksionit të tij.

3.Bagazhi personal i funksionarëve konsullorë dhe i anëtarëve të familjes së tyre do të përjashtohet nga inspektimi përderisa të ekzistojë një arsye serioze për të besuar që ai përmban materiale të tjera nga ato të përshkruara në paragrafin 1/b të këtij neni ose materiale për të cilat importi ose eksporti i tyre ndalohej nga ligjet dhe rregullat e shtetit pritës ose që u nënshtrohet ligjeve dhe rregullave për karantinë. Një kontroll i tillë kryhet në prani të funksionarit konsullor në fjalë ose të të autorizuarit prej tij.

Neni 29

1.Me përjashtim të dispozitave të paragrafeve 3 dhe 4 të nenit 22 të kësaj Konvente, privilegjet dhe imunitetet e parashikuara në këtë Konventë nuk u njihen nëpunësve konsullorë dhe anëtarëve të personelit të shërbimit nëse janë shtetas të shtetit pritës ose banues të përhershëm në atë shtet, ose që kryejnë veprimtari private fitimprurëse në shtetin pritës.

2.Anëtarëve të familjes të anëtarit të përfaqësisë konsullore që është shtetas i shtetit pritës ose banues i përhershëm në atë shtet, dhe anëtarëve të familjes të anëtarit të përfaqësisë konsullore që janë shtetas të shtetit pritës ose banues të përhershëm të atij shteti ose kryejnë veprimtari fitimprurëse në atë shtet nuk do t'u njihet ndonjë privilegj ose imunitet me përjashtim të atyre të parashikuar në paragrafin 3 të nenit 22 të kësaj Konvente.

3.Me përjashtim të dispozitave të paragrafit 3 të nenit 22 të kësaj Konvente, privilegjet dhe imunitetet parashikuar në këtë Konventë nuk do t'u njihen anëtarëve të personelit privat.

4.Shteti pritës do të ushtrojë juridiksionin e tij në lidhje me personat e përcaktuar në paragrafet 1 dhe 3 të këtij neni në mënyrë të tillë që të mos çenojë në mënyrë të panevojshme kryerjen e funksioneve nga ana e një përfaqësie konsullore.

Neni 30

Pa cenuar privilegjet dhe imunitetet e tyre, është detyra e të gjithë personave që gëzojnë imunitetet dhe privilegjet sipa kësaj Konvente të respektojnë ligjet dhe rregullat të shtetit pritës, përfshirë ato që kanë të bëjnë me trafikun e automjeteve dhe sigurimin e tyre.

KREU IV FUNKSIONET KONSULLORE

Neni 31

1.Një zyrtar konsullor gëzon në kufijtë e zonës së tij konsullore të drejtën të kryejë funksionet e parashikuara në këtë Kapitull të kësaj Konvente. Një nëpunës konsullor gjithashtu

mund të kryejë edhe detyra të tjera zyrtare përderisa nuk janë në kundërshtim me ligjet e shtetit pritës dhe ndaj tyre nuk është ngritur ndonjë kundërshtim nga ai shtet.

2. Zyrtari konsullor, pas njoftimit të drejtuar shtetit pritës, mund të veprojë si përfaqësues i shtetit dërgues në çfarëdo lloj organizate ndërqeveritare.

3. Një zyrtar konsullor mundet, në lidhje me kryerjen e funksioneve të tij, me shkrim ose me gojë, t'u drejtohet autoriteteve lokale kompetente të zonës së tij konsullore, si dhe autoriteteve qendrore kompetente të shtetit pritës, në qoftë se këtë e lejojnë ligjet, normat dhe praktika e shtetit pritës, ose marrëveshjet ndërkombëtare përkatëse.

4. Në rrethana të veçanta një zyrtar konsullor mundet, me miratimin e shtetit pritës, të kryejë funksione jashtë zonës së tij konsullore.

5. Përfaqësia konsullore mund të vendosë në territorin e shtetit pritës për veprime konsullore, pagesa dhe detyrime në përputhje me normat e shtetit dërgues. Shumat e mbledhura në formën e pagesave dhe detyrimeve të tilla, si dhe faturat për to janë të përjashtuara nga çdo lloj takse apo tatimi në shtetin pritës.

Neni 32

Zyrtari konsullor ka të drejtë të mbrojë interesat e shtetit dërgues dhe të shtetasve të tij.

Neni 33

Detyrat e një zyrtari konsullor qëndrojnë në çuarjen më tej të zhvillimit të marrëdhënieve tregtare, ekonomike, kulturore e shkencore ndërmjet shtetit dërgues dhe shtetit pritës dhe përveç kësaj në nxitjen e zhvillimit të marrëdhënieve miqësore ndërmjet tyre.

Neni 34

1. Funksionari konsullor ka të drejtë:

- a) të mbajë regjistrin e shtetasve të shtetit dërgues;
- b) të marrë njoftime dhe dokumente mbi lindjen ose vdekjen e shtetasve të shtetit dërgues;
- c) të marrë, në përputhje me ligjet e shtetit dërgues, deklarata për martesat, ose të japë licencë martesore në qoftë se të dy palët janë shtetas të shtetit dërgues

2. Një zyrtar konsullor do të lajmërojë autoritetet kompetente të shtetit pritës mbi veprimtarinë e kryer sipas pikave b dhe c të paragrafit 1 të këtij neni në qoftë se këtë e kërkojnë ligjet dhe normat e shtetit pritës.

3. Dispozitat e pikave b dhe c të këtij neni nuk i çlirojnë personat përkatës nga detyrimi që t'u përmbahen formaliteteve të kërkuara nga ligjet dhe rregullat e shtetit pritës.

Neni 35

Zyrtari konsullor ka të drejtë të:

1. T'u japë shtetasve të shtetit dërgues pasaporta dhe dokumente udhëtimi, si dhe t'i zgjasë apo t'i bëjë të pavlefshme këto pasaporta në përputhje me ligjet dhe normat e shtetit dërgues.

2. Të japë viza ose dokumente përkatëse personave që dëshirojnë të udhëtojnë në shtetin dërgues.

Neni 36

Zyrtari konsullor ka të drejtë të:

1. Të marrë, të formulojë dhe të vërtetojë deklarata të shtetasve të shtetit dërgues përfshirë

deklarata që kanë të bëjnë me çështjet familjare dhe të shtetësisë në përputhje me ligjet dhe normat e shtetit dërgues.

2.Të përpilojë, regjistrojë dhe të vërtetojë si dhe të mbajë testamentet e shtetasve të shtetit dërgues;

3.Të përpilojë, regjistrojë dhe të vërtetojë kontratat e lidhura ndërmjet shtetasve të shtetit dërgues, dhe të vërtetojë deklaratat e njëanshme të vullnetit duke u siguruar që ato nuk janë në kundërshtim me ligjet dhe rregullat e shtetit pritës. Megjithatë funksionari konsullor nuk mund të përpilojë, regjistrojë kontrata dhe deklarata të tilla që themelojnë, mbartin ose likujdojnë të drejtat reale mbi pronat e paluajtshme, të cilat gjenden në shtetin pritës.

4.Të formulojë, regjistrojë dhe vërtetojë kontrata ndërmjet shtetasve të shtetit dërgues nga njëra anë dhe shtetasve të shtetit pritës nga ana tjetër, në qoftë se këto kontrata materializohen ose sjellin efekte ligjor ekskluzivisht në shtetin dërgues, dhe me kushtin që këto të mos jenë në kundërshtim me ligjet e shtetit pritës.

5.Të legalizojë dokumente të dhëna nga autoritetet e shtetit dërgues ose ato të shtetit pritës, dhe të vërtetojë kopje, dublikata ose pjesë të këtyre dokumenteve.

6.Të përkthejë dokumentet dhe të vërtetojë përputhshmërinë e këtyre përkthimeve.

7. Të vërtetojë nënshkrimet e shtetasve të shtetit dërgues.

8.Të pranojë për ruajtje dokumente, para ose gjëra të tjera të shtetasve të shtetit dërgues ose për ta, në qoftë se kjo nuk është në kundërshtim me ligjet dhe normat e tjera të shtetit pritës. Kjo e drejtë mund të merret nga shteti pritës vetëm në qoftë se është në përputhje me ligjet dhe normat e shtetit pritës.

9.Të pranojë sende të humbura nga shtetasit e shtetit dërgues gjatë kohës së qëndrimit të tyre në shtetin pritës, me qëllim që t'ia kalojë ato personave të autorizuar.

10.Të japë dokumente mbi origjinën e produkteve.

Neni 37

Dokumentet që funksionari konsullor përpilon, vërteton ose përkthen në përputhje me dispozitat e nenit 36 të kësaj Konvente, njihen në shtetin pritës si dokumente me të njëjtin efekt ligjor, si dhe me të njëjtën fuqi ligjore, si dhe dokumentet e përpiluara, vërtetuara dhe të përkthyer nga autoritetet kompetente të shtetit pritës, në qoftë se përmbajtja e tyre nuk është në kundërshtim me ligjet dhe normat e atij shteti.

Neni 38

Me kërkesën e autoriteteve kompetente të shtetit pritës zyrtari konsullor ka të drejtë të paraqesë akte gjyqësore dhe jashtëgjyqësore dhe të zhvillojë hetime në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi ndërmjet palëve kontraktuese ose, përderisa nuk ka marrëveshje të tilla, në çfarëdo mënyrë tjetër, e cila është në përputhje me ligjet dhe normat e tjera të shtetit pritës. Kjo e drejtë mund të përdoret vetëm në rastet e shtetasve të shtetit dërgues dhe pa përdorur kurrfarë mjete presioni.

Neni 39

1. Autoritetet kompetente të shtetit pritës do të njoftojnë zyrtarin konsullor mbi nevojën e vendosjes së mbikëqyrjes ose kujdestarisë për të miturit ose për personat të cilët nuk kanë zotësinë e plotë për veprime ligjore, që janë shtetas të shtetit dërgues, ose rreth nevojës për mbrojtjen e pronës që gjendet në shtetin pritës, përderisa pavarësisht nga arsyet, nuk mund të administrohet nga shtetasit e shtetit dërgues.

2. Në konsultim me autoritetet kompetente të shtetit pritës funksionari konsullor mund të informojë shtetasit e shtetit dërgues mbi çështjet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni dhe

veçanërisht mund të propozojë personat që mund të shërbejnë si mbikëqyrës ose kujdestarë.

3. Në qoftë se nuk është i siguruar administrimi i pasurisë të të miturve ose personave që u mungon zotësia e plotë për transaksione ligjore, zyrtari konsullor mund të propozojë personin i cili mund të veprojë si administrator, ose t'u drejtohet autoriteteve kompetente të shtetit pritës të marrin masat e nevojshme.

Neni 40

Autoritetet kompetente të shtetit pritës janë të detyruar pa vonesë të lajmërojnë zyrtarin konsullor mbi vdekjen e ndonjë shtetasi të shtetit dërgues dhe do të dërgojnë pa pagesë një kopje të certifikatës së vdekjes.

Neni 41

1. Autoritetet kompetente të shtetit pritës pa vonesë do të njoftojnë zyrtarin konsullor për hapjen e trashëgimisë në atë shtet të një shtetasi të shtetit dërgues nëse trashëgimtari ligjor ose legatari është shtetas i shtetit dërgues dhe nuk ka një përfaqësues të autorizuar në shtetin pritës.

2. Kur autoritetet kompetente të shtetit pritës marrin informacion mbi hapjen e trashëgimisë së shtetasit të vdekur të shtetit dërgues në shtetin pritës, i cili nuk ka trashëgimtar ose ekzekutor të testamentit në shtetin pritës, ata do të njoftojnë pa vonesë zyrtarin konsullor të shtetit dërgues.

3. Zyrtari funksionar konsullor ka të drejtë të:

a) të ndër marrë mesat përkatëse në përputhje me ligjet dhe rregullat e shtetit pritës për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë së shtetasit të vdekur të shtetit dërgues, e cila gjendet në territorin e shtetit pritës. Për të mbrojtur interesat e shtetasve të shtetit dërgues, ai mund t'i drejtohet autoriteteve kompetente të shtetit pritës dhe të kërkojë marrjen e masave të përshtatshme për të mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë e të vdekurit, dhe të kërkojë që të informohen për masat e marra dhe të jetë i pranishëm në inventarizimin dhe vulosjen e trashëgimisë, në qoftë se ky shtetas nuk është në ndonjë mënyrë tjetër i përfaqësuar.

b) të përfaqësojë dhe të mbrojë interesat para gjykatave dhe autoriteteve të tjera të shtetit pritës të një shtetasi të shtetit dërgues që ka ose kërkon të drejta mbi trashëgiminë e gjendur në territorin e shtetit pritës pavarësisht nga shtetësia e të vdekurit, nëse shtetasi nuk gjendet në shtetin pritës ose është nën moshë, derisa ai të emërojë përfaqësuesin e tij.

4. Në rastin e hapjes së trashëgimisë së shtetasit të shtetit dërgues, autoritetet e shtetit pritës do t'i paraqesin zyrtarit konsullor një kopje të testamentit dhe të gjithë të dhënat e vlefshme mbi trashëgimtarët dhe vend qëndrimet e tyre, si dhe përbërjen dhe vlerën e trashëgimisë, si dhe informacion nëse është filluar procesi i trashëgimisë dhe në ç'fazë është ai.

5. Zyrtari konsullor, do të bashkëpunojë dhe do t'i ofrojë ndihmë, direkte ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, autoriteteve kompetente të shtetit pritës gjatë zbatimit të masave të parashikuara në paragrafet 3 dhe 4 të këtij neni.

6. Në qoftë se me mbarimin e procesit ose të formaliteteve të tjera në lidhje me trashëgiminë në shtetin pritës pronat e luajtshme ose vlera që sigurohet nga shitja e pronave të luajtshme ose të paluajtshme i takojnë trashëgimtarit, trashëgimtarit ligjor ose legatarit që është shtetas i shtetit dërgues dhe i cili nuk ka banim në shtetin pritës dhe nuk ka përfaqësuesin e tij atje, kjo pasuri ose vlera e saj nga shitja do t'i jepet funksionarit konsullor me kushtin që:

a) të jetë e konfirmuar zotësia e tij si trashëgimtar, trashëgimtar ligjor apo legatar;

b) autoritetet përkatëse të shtetit pritës të miratojnë në qoftë se është e nevojshme, kalimin e të ardhurave të trashëgimisë ose të vlerës së tyre të shitur;

c) të gjitha borxhet, të njoftuara përpara afatit të fundit të parashikuar nga legjislacioni i shtetit pritës të jenë të paguar ose siguruar;

d) që të gjitha taksat apo tatimet trashëgimore të jenë paguar ose siguruar.

Neni 42

1.Në rast vdekjeje të një shtetasi të shtetit dërgues , i cili nuk ka qëndrim të përhershëm në shtetin pritës gjatë kohës së qëndrimit të tij në këtë shtet ose tranzit, autoritetet kompetente të shtetit pritës do të mbrojnë të gjithë pronën e personit të vdekur dhe pastaj do t'i kalojnë pa asnjë formalitet të veçantë zyrtarit konsullor bartjen tek trashëgimtari apo tek ndonjë person tjetër i autorizuar. Për këtë duhet të respektohen ligjet dhe normat e shtetit pritës përsa i përket eksportit të këtyre mallrave apo parave (transferimi i parave). Funksonari konsullor do të paguajë të gjitha borxhet e të vdekurit, borxhe, të cilat i vdekuri i ka marrë gjatë qëndrimit të tij në shtetin pritës, deri në vlerën e pronës së marrë.

Neni 43

Zyrtari konsullor ka të drejtë të përfaqësojë, në përputhje me ligjet dhe normat e shtetit pritës, shtetasin e shtetit dërgues para autoriteteve kompetente të shtetit pritës, përderisa ky person nuk është i pranishëm ose për arsye të tjera të rëndësishme nuk mundet që në kohën e duhur të mbrojë të drejtat dhe interesat e tij. Ky përfaqësim do të zgjatë derisa personi në fjalë të caktojë përfaqësuesin e tij ose vetë personalisht të sigurojë mbrojtjen e të drejtave dhe detyrimeve të tij.

Neni 44

1.Zyrtari konsullor ka të drejtë të mbajë kontakte dhe të takohet me çdo shtetas të shtetit dërgues, t'i japë këshilla dhe ndihmë atij dhe në qoftë se është e nevojshme t'i sigurojë ndihmë ligjore. Shteti pritës në asnjë mënyrë nuk do të kufizojë takimin e shtetasve të shtetit dërgues me zyrtarin konsullor apo hyrjen në përfaqësinë konsullore.

2.Autoritetet kompetente të shtetit pritës pa asnjë vonesë dhe, jo më vonë se tre ditë nga data kur janë marrë masa të tilla, do të lajmërojnë zyrtarin konsullor të shtetit dërgues mbi arrestimin, burgosjes apo kufizimin e lirisë në çfarëdo mënyre tjetër të shtetasit të shtetit dërgues. Autoritetet përkatëse janë të detyruara që t'i dërgojnë pa vonesë zyrtarit konsullor çdo lloj njoftimi nga personi i burgosur, arrestuar apo që i është nënshtruar ndonjë forme tjetër të kufizimit të lirisë.

3.Zyrtari konsullor ka të drejtë menjëherë, d.m.th. në një afat prej katër ditësh ta vizitojë dhe të vendosë kontakt me shtetasin e shtetit dërgues, i cili është i burgosur, arrestuar apo i është nënshtruar ndonjë forme tjetër të kufizimit të lirisë. E drejta e parashikuar me këtë paragraf do të përdoret në përputhje me ligjet dhe rregullat e tjera të shtetit pritës, me kushtin që këto ligje dhe rregulla të mos e pengojnë këtë të drejtë.

4.Autoritetet kompetente të shtetit pritës do të njoftojnë pa vonesë zyrtarin konsullor të shtetit dërgues për çdo aksident apo incident të rëndë që ka për pasojë vdekjen ose plagosje të rënda të shtetasve të shtetit dërgues.

Neni 45

1.Zyrtari konsullor ka të drejtë t'i ofrojë çdo ndihmë anijes së shtetit dërgues, ekuipazhit të saj, si dhe udhëtarëve gjatë qëndrimit në portet, në ujërat territoriale ose ujërat e brendshme të shtetit pritës.

2.Zyrtari konsullor mund të hypë në anijen e shtetit dërgues menjëherë pasi kësaj anijeje t'i lejohet hyrje e lirë në breg, kur komandanti, anëtarët e tjerë të ekuipazhit dhe udhëtarët mund të komunikojnë me të.

3.Zyrtari konsullor mund të përdorë të drejtën e mbikëqyrjes dhe të inspektimit lidhur me

anijet e shtetit dërgues, si dhe ekuipazhit të tij. Në këtë kuptim ai mund të vizitojë anijen dhe të jetë i vizituar nga Komandanti dhe anëtarët e tjerë të ekuipazhit.

4. Zyrtaresi konsullor mund të kërkojë ndihmë nga autoritetet përkatëse të shtetit pritës për çfarëdo çështje që lidhet me kryerjen e funksioneve të tij përsa i përket anijeve të shtetit dërgues, ose të Komandantit të anijes, anëtarëve të tjerë të ekuipazhit dhe pasagjerëve të anijes.

Neni 46

Zyrtari konsullor përsa i përket anijeve të shtetit dërgues ka të drejtë:

1. pa dëmtuar pushtetin e autoriteteve të shtetit pritës, të hetojë për çdo incident që ka ndodhur në anije gjatë udhëtimit apo qëndrimit, të pyesë Komandantin dhe anëtarët e tjerë të ekuipazhit, të shqyrtojë dokumentet e anijes, të marrë deklarata mbi anijen, ngarkesën dhe udhëtimin, si dhe të lehtësojë ardhjen, largimin si dhe qëndrimin e anijes në port;

2. të zgjidhë mosmarrëveshjet të çdo lloji ndërmjet komandantit të anijes dhe anëtarëve të tjerë të ekuipazhit, duke përfshirë edhe mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me pagat dhe kontratat e shërbimit;

3. të marrë hapat e duhur për të siguruar mjekimin dhe riatdhesimin e komandantit të anijes, si dhe anëtarëve të tjerë të ekuipazhit;

4. të rregullojë mbrojtje ligjore për Komandantin e anijes dhe anëtarët e tjerë të ekuipazhit gjatë kontakteve të tyre me gjykatat dhe autoritetet e tjera të shtetit pritës dhe në këtë kontekst t'u sigurojë atyre mbrojtje ligjore dhe ndihmë për përkthim;

5. të përpilojë, të marrë, të regjistrojë ose të autorizojë deklarata ose dokumente të tjera, të cilat kanë të bëjnë me anijen dhe të cilat janë të parashikuara nga ligjet e shtetit dërgues.

6. të ndërmarrë çfarëdolloj masash të tjera të parashikuara nga ligjet e shtetit dërgues përsa i përket lundrimit me anije, në qoftë se këto masa nuk janë në kundërshtim me ligjet dhe normat e tjera të shtetit pritës.

Neni 47

1. Gjykatat dhe autoritetet e tjera kompetente të shtetit pritës mund të mos e ushtrojnë juridiksionin e tyre përsa i përket veprave penale të kryera në anijen e shtetit dërgues, përveç se në këto raste:

a) vepra penale të kryera nga ose kundër shtetasve të shtetit pritës ose nga çdo person tjetër, i cili nuk është anëtar i ekuipazhit të anijes ose kundër një personi të tillë;

b) veprë penale, e cila shkakton prishjen e rendit publik, sigurisë në port ose ujërat territoriale apo të brendshme të shtetit pritës;

c) vepra penale ndërmjet të cilave thyhen ligjet dhe normat e tjera të shtetit pritës në fushën e shëndetit publik, sigurisë së jetës në det, imigrimit, normave doganore, ndotja e detit ose transporti ilegal i drogës;

d) veprat penale, të cilat sipas ligjeve të shtetit pritës janë parashikuar dënime me burg në një kohë zgjatjeje prej jo më pak se pesë vjetësh ose më të rënda.

2. Në rastet e tjera autoritetet në fjalë mund të veprojnë vetëm me kërkesën ose me miratimin e zyrtarit konsullor.

Neni 48

1. Në qoftë se organet gjyqësore apo autoritetet e tjera të shtetit pritës synojnë të zbatojnë masa forcimi, marrje të pronësisë ose të kryejnë hetime në anijen e shtetit dërgues, autoritetet kompetente të shtetit pritës do të lajmërojnë paraprakisht për këtë zyrtarin konsullor për t'i dhënë mundësi këtij të fundit ose përfaqësuesit të tij që të jetë i pranishëm. Në qoftë se ky lajmërim është i pamundur, autoritetet kompetente janë të detyruara ta bëjnë këtë në afatin më të shkurtër

dhe jo më vonë se koha kur aktiviteti i përmendur është parashikuar të fillojë. Autoritetet kompetente të shtetit pritës do të lehtësojnë komunikimin e zyrtarit konsullor me personin e burgosur ose të arrestuar, dhe ndërmarrjen e masave të tjera të nevojshme për të mbrojtur interesat e një personi të tillë.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni do të zbatohen gjithashtu edhe në rast se duhet të pyeten në tokë komandanti apo anëtarët e tjerë të ekuipazhit nga autoritetet e shtetit pritës.

3. Dispozitat e këtij neni nuk do të zbatohen në kontrollin rutinë doganor, sanitar dhe kontrollin e pasaportave, ose për çdo aktivitet të kryer me kërkesën e komandantit të anijes ose me miratimin e tij.

Neni 49

Nëqftëse anëtari i ekuipazhit nuk është shtetas i shtetit dërgues braktis anijen në këtë shtet pa miratimin e komandantit të anijes së shtetit dërgues, autoritetet kompetente të shtetit pritës me kërkesën e zyrtarit konsullor do të ofrojnë ndihmë në kërkimin e këtij personi.

Neni 50

1. Në qoftë se një anije e shtetit dërgues mbytet, dëmtohet, ngec ose hidhet në bregdet, ose pëson çfarëdo lloj dëmtimi tjetër në shtetin pritës, ose në qoftë se ndonjë mall, i cili bën pjesë në ngarkesën e saj gjendet si rrjedhim i ngecjes në breg të detit të shtetit pritës, ose afër bregut të detit të shtetit pritës apo është sjellur në ndonjë port të atij shteti, autoritetet kompetente të shtetit pritës do të njoftojnë pa vonesë për këtë gjë zyrtarin konsullor.

2. Në rastet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, autoritetet kompetente të shtetit pritës do të marrin gjitha masat e duhura për të rregulluar shpëtimin e anijes dhe mbrojtjen e saj, si dhe të udhëtarëve dhe anëtarëve të ekuipazhit që gjenden në të, pajisjet e anijes, ngarkesa inventari dhe mallrat e tjera që gjenden në anije si dhe të parandalojë shkatërrimin e pasurisë. Kjo gjithashtu lidhet me objektet që janë pjesë e anijes ose ngarkesës së saj, të cilat janë gjetur jashtë anijes. Autoritetet kompetente të shtetit pritës pa vonesë do të lajmërojnë zyrtarin konsullor mbi të gjitha veprimtaritë e ndërmarra në lidhje me të.

3. Zyrtari konsullor mund t'i ofrojë të gjithë ndihmën e duhur kësaj anijeje, udhëtarëve të saj, si dhe anëtarëve të ekuipazhit dhe për këtë qëllim mund të kërkojë ndihmë nga autoritetet kompetente të shtetit pritës. Zyrtari konsullor mund të kërkojë që të fillojnë veprimtaritë e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni dhe të kërkojë të fillojë ose të vazhdojë riparimi i anijes, ose mund të kërkojë nga autoritetet kompetente të shtetit pritës që të ndërmarrin këtë aktivitet.

4. Në qoftë se anija, e cila ka pësuar mbytje ose çfarëdolloj malli i saj gjendet në breg ose afër bregut të shtetit pritës ose është mbartur në portin e këtij shteti dhe as Komandanti i anijes ose pronari i saj, agjenti i tij apo siguruesi nuk kanë patur mundësi të marrin masat për të siguruar ose kontrolluar këtë anije ose mall, zyrtari konsullor, konsiderohet i autorizuar në emër të pronarit të ndërmarrë të gjitha masat organizative që do t'i merrte edhe vetë pronari për këtë qëllim. Dispozitat e këtij paragrafi do të zbatohen për çfarëdolloj malli i cili ka bërë pjesë në ngarkesën e kësaj anijeje.

5. Në qoftë se ndonjë mall, i cili është pjesë e ngarkesës së anijes së mbytur të ndonjë shteti të tretë dhe që është pronë e ndonjë shtetasi të shtetit dërgues, është gjendur në breg ose afër bregut të detit të shtetit pritës ose është sjellë në portin e këtij shteti dhe as komandanti i anijes ose pronari i saj, as agjenti dhe as siguruesi nuk kanë patur mundësi të ndërmarrin masat për të siguruar ose kontrolluar mallin, zyrtari konsullor do të konsiderohet i autorizuar në emër të pronarit të ndërmarrë të gjitha masat organizative, të cilat do t'i merrte edhe vetë pronari për këtë qëllim.

Neni 51

1.Në qoftë se pronari ose ndonjë anëtar tjetër i ekuipazhit të anijes vdes ose humbet në shtetin pritës, komandanti ose zëvendësi i tij dhe zyrtari konsullor i shtetit dërgues janë të vetmit persona të autorizuar për të bërë inventarin e objekteve, mjeteve monetare apo pronave të tjera të cilat le pas vetes personi i vdekur apo i zhdukur dhe të ndërmarrin veprime për mbrojtjen e pasurisë ose kalimin e saj me qëllim likuidimin e trashëgimisë.

2.Në qoftë se komandanti zbulon se ndonjë anëtar tjetër i ekuipazhit të anijes, i cili është shtetas i shtetit pritës vdes ose zhduket, komandanti ose zëvendësi i tij, do t'u dërgojnë një kopje të inventarit sipas paragrafit 1 të këtij neni autoriteteve të shtetit pritës, që janë të autorizuar të ndërmarrin të gjitha veprimtaritë e duhura për mbrojtjen e pasurisë dhe në qoftë se është e nevojshme likuidimin e trashëgimisë. Autoritetet do të njoftojnë përfaqësinë konsullore të shtetit dërgues mbi veprimtari të tilla.

Neni 52

Dispozitat e neneve 45 dhe 51 të kësaj Konvente do të zbatohen gjithashtu edhe për avionët me kushtin që zbatimi i tyre nuk është në kundërshtim me normat e marrëveshjeve ajrore të tjera bilaterale apo multilaterale, të cilat janë detyruese për të dyja palët kontraktuese.

Neni 53

1.Nenet e kësaj Konvente do të zbatohen në të njëjtën mënyrë nëse funksionet konsullore kryen nga një mision diplomatik.

2.Emrat e anëtarëve të misionit diplomatik, që janë caktuar në sesionin konsullor ose zgjedhur për të ushtruar funksione konsullore të misionit në çfarëdo mënyre tjetër do t'i komunikohen Ministrisë së Punëve të Jashtme të shtetit pritës ose autoriteteve të përcaktuara nga kjo Ministri.

3.Në kryerjen e funksioneve të saj konsullore, misioni diplomatik mund t'u drejtohet:

a)autoriteteve lokale të zonës konsullore;

b)autoriteteve qendrore të shtetit pritës, në qoftë se këtë e lejojnë ligjet në fuqi normat dhe zakonet që zotërojnë në shtetin pritës, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare me rëndësi.

4.Privilegjet dhe imunitetet e anëtarëve të misionit diplomatik për të cilët flitet në paragrafin 2 të këtij neni vazhdojnë t'u nënshtrohen normave të së drejtës ndërkombëtare mbi marrëdhëniet diplomatike.

KREU V DISPOZITA MBYLLËSE

Neni 54

1.Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit dhe do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë nga data e njoftimit të fundit me të cilin palët kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike, se ata kanë plotësuar procedurat e brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

2.Kjo konventë lidhet për një kohë të papërcaktuar. Ajo mund të mbarojë nëpërmjet njoftimit nga çdonjëra nga palët kontraktuese. Në këtë rast ajo pushon së qeni në fuqi gjashtë muaj pas datës së paraqitjes së njoftimit mbi mbarimin.

Në dëshmi të saj të Plotfuqishmit përkatës të Palëve Kontraktuese nënshkruajnë këtë Konventë duke vënë edhe vulat e tyre.

E bërë në Tiranë, me datë 14.9.1996, në dy origjinale, secila në gjuhët shqip, kroatisht

dhe anglisht, duke qenë të dy tekstet njësoj autentike. Në rast divergjence në interpretim do të mbizotërojë teksti anglisht.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

PËR REPUBLIKËN E KROACISË